

RAPORTI I KONKURRUESHMËRISË 2024: SHQIPËRIA LIDER NË RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR



OECD certifikon progresin e Shqipërisë, në Konferencën e Nivelit të Lartë për Evropën Juglindore në Paris, ku u prezantua Raporti i OECD për Konkurrueshmërinë 2024 (viti 2023 krahasuar me vitin 2021) për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Raporti Competitiveness Outlook vlerëson politikat e vendeve të Evropës Juglindore në 15 dimensione kryesore, duke analizuar 440 indikatorë të ndryshëm ekonomik e sektorial, për të ndihmuar ekonomitë e rajonit të përmirësojnë politikbërjen dhe të rrisin konkurrueshmërinë.

Shqipëria ka shënuar progres të madh në shumë dimensione, duke përfshirë politikat e punësimit, turizmit, ato tregtare, mjedisin e bujqësinë, energjinë, aksesin në financë, politikat anti-korrupsion, edukimin, shoqërinë digjitale, nxitjen e investimeve, etj. Vendi ynë është lider për rajonin në 13 nga 15 dimensionet e Raportit!

Qeveria Shqiptare është e angazhuar të ndjekë dhe zbatojë rekomandimet e raportit, duke synuar një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, të orientuar drejt tranzicionit të gjelbër dhe digjital, me politika të përfshirjes sociale dhe punësimit që sigurojnë integrimin dinjitoz të Shqipërisë në BE.

NISIN PUNIMET PËRFORCUESE NË “URËN E ZOGUT”

Në urën me harqe ose siç njihet ndryshe “Ura e Zogut”, monument kulture për vlerat e saj arkitektonike të kohës, kanë nisur punimet përforcuese. Ky monument kulture, i cili është pjesë e listës së pasurive në rrezik nga “Europa Nostra”, po i nënshtrohet një ndërhyrjeje shpëtuese, si fazë e parë përforcuese. Në vijim pason restaurimi thelbësor, ku ekspertët po verifikojnë thellësinë e zhytjes së themelit dhe ndërthurjen e strukturës mbajtëse të çeliktë me këmbën e urës, veçanërisht për shkak të ndërtimit në mjedis me ujë dhe për shkak të çedimit dhe animit të këmbës së urës.

Ky projekt pritet të kthejë për publikun, për qëllime panoramike e pelegrinazhi, një tjetër objekt trashëgimie, të aksesueshëm e të kalueshëm nga vizitorët dhe të shfrytëzueshëm për komunitetin e zonës.



TRASHËGIMIA KULTURORE DHE ZONAT E MBROJTURA, UNESCO VLERËSON POZITIVISHT INSTITUCIONET SHQIPTARE PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxja, së bashku me Ministren e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro zhvilluan një takim mjaft pozitiv në UNESCO.

Institucionet shqiptare u vlerësuan pozitivisht për angazhimin serioz dhe progresin në ndjekjen e detyrave dhe rekomandimeve të UNESCO-s, si dhe për shkëmbimet e mendimeve dhe informacioneve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve shqiptare të trashëgimisë botërore dhe zonave të mbrojtura, duke vlerësuar veçanërisht zhvillimin e bujshëm të turizmit në dy vitet e fundit në Shqipëri, si një nga destinacionet e reja më të preferuara.



MUZETË KOMBËTARË
148,156 VIZITORE
 JANAR - MAJ 2024
+71.4%
 KRAHASUAR ME 2023

INTERESI PËR MUZETË JANAR - MAJ 2024, RITJE ME 71,4%, KRAHASUAR 2023

Interesi i vizitorëve për Muzetë Kombëtarë dhe historinë e Shqipërisë është gjithnjë e në rritje. Në total 148,156 vizitorë kanë vizituar muzetë kombëtarë në periudhën janar-maj 2024, me një rritje prej 71,4%, krahasuar me vitin 2023.

RRITJA E PAGAVE NGA 1 KORRIKU, ZBARDHET VENDIMI PËR KATEGORITË PËRFITUESE

Qeveria miratoi rritjen e pagave për Administratën Publike dhe vendimi hyn në fuqi me 1 korrik 2024. Rritja e pagave nuk është vetëm një instrument për të vlerësuar profesionistët për punën e tyre të përditshme, por është mbi të gjitha pjesë e pandashme e vizionit të Qeverisë për Shqipërinë 2030.

Politika e rritjes së pagave mbart një buxhet shtesë prej 517 milionë lekësh, për të gjithë punonjësit e MEKI-t, për vitin 2024. Paga mesatare për specialistët në administratën publike të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të jetë 113,333 lekë/muaj, duke shënuar një rritje prej 35% krahasuar me vitin 2023.

RRITJE PAGE
 PËR **4,112**

PUNONJËS TË MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

517 MLN LEKË
 Buxheti 2024



INTERESI PËR PARQET ARKEOLOGJIKE, RRIJTJE ME 53.3% KRAHASUAR ME 2023

Turistë vendas dhe të huaj kanë shfaqur interes të shtuar për parqet tona arkeologjike. Në total 136,293 persona kanë vizituar parqet tona arkeologjike gjatë 5-mujorit të parë të 2024, e përkthyer ndryshe 53,3% më shumë turistë, krahasuar me 2023.

MARRËVESHJA ME ITALINË PËR SIGURIMET SHOQËRORE, PËRFITUES MBI 500 MIJË SHQIPTARË



Shqipëria dhe Italia po avancojnë në diskutimet për aspektet teknike, që do të sigurojnë zbatimin e marrëveshjes dypalëshe, në fushën e sigurimeve shoqërore.

Zëvendësministrja e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit znj. Olta Manjani dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale znj. Caterina Francomano, zhvilluan bisedime të frytshme dhe ranë dakord për përmbajtjen e Marrëveshjes Administrative, si dhe për të shkëmbyer draftet e formularëve përkatës.

Me qëllim që Marrëveshja e Sigurimeve Shoqërore të bëhet e zbatueshme pas shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit, të dy delegacionet u angazhuan të zhvillojnë sa më shpejt takime të ndërsjella ndërinstucionale.

Mbi 500 mijë shtetas shqiptarë, të cilët jetojnë e punojnë në Itali, pritet të përfitojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshje, e cila u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë pak kohë më parë.

U DËMTUA NGA TËRMETI, RESTAUROHET KALAJA E ISHMIT

Kalaja e Ishmit, një nga sitet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, u restaurua falë programit EU4Culture të financuar nga BE dhe zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Në pjesën lindore të kalasë, pjesë e Bashkisë Durrës, mund të shohësh pllajën e Ishmit, malin e Krujës dhe Dajtit, ndërsa në perëndim, deltën e lumit Ishëm, Kepin e Rodonit dhe një pjesë të bregut të detit Adriatik. Ky sit u dëmtua nga tërmeti i vitit 2019 dhe ishte në gjendje kritike para restaurimit, por tashmë është e vizitueshme nga turistët.



MARRËVESHJA QEVERTARE G2G, MINISTRI GONXHJA TAKOHET ME AMBASADOREN E FRANCËS

Marrëveshja qeveritare G2G ka si synim forcimin e lidhjeve ndërmjet dy shteteve dhe zbatimin e projekteve strategjike për zhvillim profesional dhe teknologjik, duke kontribuar në mirëpërgatitjen e Shqipërisë, si treg dhe si realitet ekonomik, për anëtarësimin në BE.

Bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve ndër të tjera ka në fokus shërbimet publike, investimet, modernizimin e infrastrukturës, asistencën për zhvillimin e ekosistemit të inovacionit, qeverisjes elektronike, sigurisë kibernetike, si dhe optimizimin e burimeve njerëzore për të arritur standardet e Bashkimit Evropian.


Kjo marrëveshje mbështet sjelljen e kontributit të Francës në Shqipëri, me tërë kapacitetin dhe mundësitë që ky shtet ka dhe ofron, për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit paralel me integrimin tonë në Bashkimin Evropian.



“THE ALBANIAN KEY”, SKULPTURA MONUMENTALE NGA MJESHTRI SHQIPTARO-ITALIAN ALFRED MIRASHI MILOT

“The Albanian Key”, një ndër projektet fituese të Konkursit Ndërkombëtar “Art në Hapësirën Publike”, është vendosur në hyrje të qytetit të Shkodrës, duke sjellë një dimension të ri estetik dhe kulturor.

Skulptura monumentale nga mjeshtri shqiptaro-italian Alfred Mirashi Milot, mbart një mesazh të fuqishëm dhe të qartë: t’i japim fund dyerve të mbyllura dhe të hapim shanse për të gjithë, duke krijuar mundësi të barabarta për çdo njeri. Vepra u financua nga MEKI, kuruar nga Albert Vataj, Massimo Guastella e Ji Shaofeng.



KREDI ME 0% INTERES, PËRFITOJNË 300 PUNONJËS TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Ky program ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së punonjësve, duke u siguruar atyre mundësinë për të jetuar në kushte më të mira dhe më të sigurta, pa u shpenzuar për interesat e kredisë.

Përfituesit do të përzgjidhen në bazë të sistemit të pikëzimit dhe vëmendje të veçantë në këtë proces do të kenë: arsimtarët, mjekët, infermierët, policët, ushtarakët, garda, veterinerët, artistët, etj. Këto kuota do të jenë të përvitshme, falë financimit nga Buxheti i Shtetit, miratuar në mbledhjen e Qeverisë me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.





Interesi për kalatë Janar-Maj 2024, rritje me 60.1% krahasuar me 2023

Kalatë dhe monumentet e kulturës presin çdo ditë e më shumë vizitorë nga i gjithë vendi dhe bota. Për periudhën janar-maj 2024 kalatë u vizituan nga 66,323 vizitorë, duke pësuar një rritje me 60.1%, në krahasim me vitin që lamë pas.

FONDI RAJONAL I SFIDAVE DHE KfW, NË FOKUS FORMIMI PROFESIONAL I TË RINJVE



Mungesa e forcës punëtore në vendet e Rajonit dhe nevoja e zhvillimit të kapitalit njerëzor, ishin dy nga çështjet kryesore që u diskutuan në takimin me përfaqësues të Fondit Rajonal të Sfidave dhe KfW, në Konferencën Rajonale të organizuar në Tiranë.

Me iniciativën e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore dhe

në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës Federale të Gjermanisë në vendin tonë, si dhe me përfaqësuesit e KfW dhe të Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim, kemi krijuar “Dritare Unike” vetëm për Shqipërinë, me një vlerë prej 10 milionë Euro.

Në thirrjen e tretë janë shpallur 10 konsorciume shqiptare fituese, nga të cilat 7 Institucione Publike të Arsimit dhe Formimit Profesional, të cilat përfitojnë fondin 5,390,834 Euro.

Nëpërmjet këtyre projekteve dhe financimeve, shkollat profesionale dhe qendrat publike të formimit profesional plotësojnë një pjesë të nevojave të tyre që janë të lidhura me infrastrukturën, pajisjet/laboratorët apo trajnimet e stafëve drejtuese dhe mësimdhënëse, duke hapur rrugën për zhvillim të arsimit dhe bashkëpunimit me sektorin privat, e duke rritur mundësitë e punësimit sipas standardeve më të larta të kualifikimit.

TUNELET NËNTOKËSORE TË KUKËSIT, INXHINIERËT BRITANIKË PO STUDIOJNË STRUKTURËN PËR T’I KTHYER NË HAPËSIRA MULTIFUNKSIONALE KULTURORE

Kukësi ka sot një vëmendje të veçantë, si një zonë me resurse të shumta, për të rritur ekonominë lokale përmes maksimalizimit të të gjitha kapaciteteve. Ministra e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, do të vijojë të mbështesë, jo vetëm Kukësin, por të gjithë veriun, zonat malore e rurale, si një mision i rëndësishëm për vendin, turizmin dhe zhvillimin e komuniteteve. Së bashku me oficerët britanikë dhe Bashkinë Kukës, po punohet për një projekt të përbashkët ku inxhinierët me background ushtarak, po studiojnë të gjithë strukturën nëntokësore, e cila shumë shpejt do të shfaqet në formën e një harte 3D, e që do të kthehet në një hapësirë multifunksionale kulturore, shërbimesh rekreative e inovative si një mundësi për gjenerim aktiviteti ekonomik e turistik të zonës.



THIRRJA PËR RIKONSTRUKSIONIN E SHKOLLAVE DHE QENDRAVE PROFESIONALE, MINISTRI GONXHJA TAKOHET ME ARKITEKTËT E THIRRJES PROBONO



Takimi me arkitektët që i'u bashkuan thirrjes probono për realizimin e 14 projekt-ideve për rikonstruksionin e shkollave dhe qendrave profesionale.

Këto shkolla dhe qendra profesionale do të jenë në shërbim të mbi 10 mijë nxënësve dhe kursantëve çdo vit. Falenderojmë të gjitha studiot e arkitekturës që i'u përgjigjën kësaj thirrje dhe për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që koordinuan këtë proces, i cili kontribuon në rritjen e cilësisë së arsimit dhe formimit profesional.

Projekt-idetë do të zbatohen me mbështetjen shtesë për investimet që do të jepen nga buxheti i shtetit për të fuqizuar arsimin profesional në funksion të nevojave të tregut të punës.

PLANI I PUNËSIMIT TË FAMILJEVE NË NDIHMË EKONOMIKE, 2053 ANËTARË U INTEGRUAN NË TREGUN E PUNËS NË 5-MUJORIN E PARË

Përmes planit të punësimit të aktivizimit të familjeve në ndihmë ekonomike, janë në total 2053 anëtarë të integruar në tregun e punës dhe aftësive, në 5-mujorin e parë të 2024.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkitë përkatëse po koordinojnë të gjithë procesin për të identifikuar anëtarët e familjeve në ndihmë ekonomike të punësueshëm, për të hartuar planet individuale të punësimit, për të aftësuar këtë kategori përmes kurseve profesionale dhe për t'i ndërmjetësuar në tregun e punës dhe programeve të nxitjes së punësimit.

SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË, ZERO TOLERANCË PËR SHKELËSIT E LIGJIT

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore vijon me kontrollet e kantierëve të ndërtimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim parandalimin e aksidentëve në punë, përmirësimin e kushteve për punëmarrësit që punojnë në këtë sektor, si dhe për forcimin e kulturës për siguri në punë.

Për shkelësit e ligjit, do të ketë tolerancë zero, në çdo rast që do të konstatohet nga Inspektorët e Punës.



MEKI I BASHKOHET NISMËS “MJAFTOJNË VETËM 10 MINUTA PËR TË SHPËTUAR 3 JETË”

Stafi i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit pa asnjë hezitim iu përgjigj kërkesës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut për të dhuruar gjak në fushatën “Mjaftojnë vetëm 10 minuta për të shpëtuar 3 jetë”, një nismë kjo që i’u vjen në ndihmë fëmijëve talasemikë. Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja falënderoi të gjithë ata kolegë që ishin në gjendje të bëheshin pjesë e kësaj kauze kaq fisnike, humanitare dhe qytetare, duke shprehur njëkohësisht mirënjohje për stafin e përkushtuar të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, për gjithë profesionalizmin e treguar gjatë ushtrimit të detyrës së tyre humane.



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA, NIS TRAJNIMI I EKIPEVE TË ANGAZHUARA NË PROCESIN E PROKURIMIT

Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP sh. a.), shoqëria e re në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, e cila ka nisur operimin nga 25 prilli 2024, hapi siparin e ofrimit të konsulencës në fushën e prokurimit publik. Në aktivitetin e përqendruar kryesisht në saktësimin e dokumenteve të procedurave prokuruese morën pjesë punonjës të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ekipet e angazhuara në proceset e prokurimit, nevojitet të shtojnë njohuritë në mënyrë të thelluar dhe të vazhduar, për të siguruar transparencë dhe efikasitet maksimal gjatë kryerjes së procedurave.

Konsulenca për autoritetet publike do të jetë një shërbim i ri zyrtar i OBP, krahas kryerjes së procedurave të prokurimit, që do të ofrohet në vazhden e aktivitetit operativ.



MIRATOHET PROGRAMI I RI-INTEGRIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE PËR PUNËKËRKUESIT

Programi i ri-integrimit social, ofron shërbime mbështetëse si edhe mbështetje financiare për pjesëmarrjen në program, të tilla si: pagesë për pjesëmarrje; bonuse për shpenzime të transportit; bonuse për kujdesin e fëmijëve në ngarkim dhe/ose të moshuarve apo personave të sëmurë në ngarkim; dhe garantimin e një kontrate pune me afat maksimal deri në 6 muaj, pas përfundimit të programit.’

Miratimi i këtij projektvendimi është vendosur si një nga indikatorët e Mbështetjes Buxhetore të BE-së për Shqipërinë në kuadër të programit të ri të BE-së “Reform Agenda për Ballkanin Perëndimor”. Programi synon të targetojë punëkërkuesit e papunë të regjistruar pranë zyrave të punësimit me fokus: përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike; gratë që banojnë në njësitë administrative vendore; romët dhe egjiptianët; personat me aftësi të kufizuar, etj. Detajet e aplikimit do të bëhen të ditura se shpejti.

SË SHPEJTI TEATRI I RI I KUKULLAVE

Punimet restauruese në Teatrin Kombëtar të Kukullave, dikur vendndodhja e Parlamentit të parë Shqiptar, po vazhdojnë në kuadër të programit EU4Culture. I ndërtuar në vitin 1924, në ndërtesë fillimisht ishte menduar të vendosej Klubi i Oficerëve. Megjithatë, për shkak të mungesës së një hapësire alternative grumbullimi, aty u prit Parlamenti i parë shqiptar. Pas kryerjes së funksioneve të ndryshme ndër vite, në vitet 1960, ndërtesa u shndërrua në Teatrin Kombëtar të Kukullave, rol që vazhdon ta kryejë edhe sot e kësaj dite. Ndërtesa po i nënshtrohet punimeve restauruese në kuadër të programit EU4Culture. Me përfundimin e tyre, Teatri Kombëtar i Kukullave do të ketë përmirësime në përputhje me standardet bashkëkohore të performancës audio-vizuale, me një skenë dhe auditor multifunksional.



APLIKACIONI TEA, MINISTRIA MBËSHTET MBI 2,300 EVENTE KULTURORE PËR 2024

Ky sezon veror vjen me një kalendar të pasur dhe të larmishëm kulturor dhe artistik për vitin 2024, i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë në aplikacionin "Tourism Events Albania".

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit mbështet mbi 2,300 evente kulturore gjatë gjithë vitit 2024. Vetëm në periudhën maj-qershor të këtij viti, janë mbështetur 275 aktivitete të skenës së pavarur, duke përfshirë shfaqje, festivale dhe evente falas në natyrë. Këto aktivitete shtrihen në të gjithë vendin dhe janë lehtësisht të aksesueshme përmes aplikacionit TEA. Kalandari artistik e kulturor do të vijojë të pasurohet, duke rritur mbështetjen për kulturën, artin, trashëgiminë, traditat, etnografinë, folklorin dhe gjithçka që na bën krenarë që jemi shqiptarë.

NGA KARNAVALET TEK KONCERTET, JAVËT KULTURORE ITALIANE, IZRAELITE E BRAZILIANE SOLLËN PËR NJË MUAJ NJË ATMOSFERË TË MREKULLUESHME NGA VERIU NË JUG!



Magjia e Javëve Kulturore Ndërkombëtare, nismë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit vijoi edhe në muajin qershor me Italinë, Izraelin dhe Brazilin.

Siparin e aktiviteteve përgjatë këtij muaji e ngriti Java Kulturore Italiane, e cila solli në Tiranë, Sarandë, Gjirokastër, Vlorë, Berat, Gramsh dhe Durrës, nga datat 2 deri në datën 8 qershor një sërë aktivitesh që përfaqësuan thelbin dhe më të mirën e një kulture që admirohet nga e gjithë bota, e që ja vlejti të përjetohej.

Gjithçka u çel me një event madhështor që festoi historinë, kulturën dhe trashëgiminë e Parkut Kombëtar Arkeologjik të Butrintit në Sarandë. Ishte grupi artistik “Artemis Danza”, i cili ofroi emocione të forta me interpretimin muzikor, koreografik dhe vizual të 4 akteve të veprës operistike “Voci di Donne”, të kompozitorit legjendar Puccini. E pa dyshim, përzgjedhja e skenës nuk kishte si të ishte rastësore. Mbajtja e kësaj shfaqje artistike që “zgjoi gurët” e antikitetit nga gjumi i thellë në Butrint, erdhi në kuadër të 100 vjetorit të zbulimit të Parkut Kombëtar Arkeologjik aq të vizituar nga miliona turistët që vijnë në Shqipëri për të kaluar pushimet.

Aktivitetet e shumta të organizuara nga ambasada Italiane, u mbyllën më 8 qershor me muzikë e ato ishin të shpërndara nga Tirana në Durrës e deri në Shkodër. Në Tiranë ishte DJ shumë i talentuar Fred Simon, i cili solli një set me muzikë të zgjedhur me kujdes, në Tunel Terrace. Ndërsa në Kalanë e Rozafës, në Shkodër atmosfera u elektrizua nga DJ Jolly Mare. Energjia në Durrës u ndez nga grupi i mirënjohur Rione Junno që përveç atmosferës festive, nxori në pah trashëgiminë e pasur dhe frymën novatore të muzikës etnike.

JAVA KULTURORE IZRAELITE



Pas Italisë, radha ishte e Javës Kulturore të Izraelit, kultura e së cilit u shpalos më së miri në datat 9 deri më 14 qershor.

Aktivitetet u çelen me shfaqjen e filmit “A matter of size” i cili rrëfen historinë e një grupi burrash mbipeshë nga Izraeli që janë të lodhur nga dietat dhe përpiqen të gjejnë një mënyrë të re për të pranuar trupat e tyre duke u bërë sumo, mundës. Një film që jep mesazhe të jashtëzakonshme mbi pranimin e stereotipeve shoqërore dhe vetë-pranimin, u prit me mjaft kureshtje nga admiruesit e kinemasë në vendin tonë.

Akademia e Arteve Bezalel, një institucion i njohur në Izrael dhe pikërisht vendi ku filloi Fjalori Sionist i Simboleve, solli për 4 ditë me radhë tek piramida e Tiranës, ekspozitën “Serenity”. Shumica e veprave të artit të kësaj ekspozite janë krijuar përpara fillimit të së Shtunës së Zezë më 7 tetor 2023, ndërsa vizitorët hynë në një udhëtim përmes imazheve të tjetërsuara të peizazheve lokale.

Nuk kishte si të mbyllej ndryshe, java e Izrael përveç se me një Street Party tek instilacioni “Reja” nga tre DJ të talentuar, dy izraelitë dhe një shqiptar. Alon Nazarov, i njohur si "Jackalon", bëri që të gjithë të pasionuarit pas muzikës elektronike e moderne të përjetojnë një natë unike dhe frymëzuese.



JAVA KULTURORE E BRAZILIT



Javët kulturore Ndërkombëtare, sollën për herë të parë në Shqipëri Javën Kulturore Braziliene nga datat 21 deri më 29 Qershor të cilat u shtrinë nga Tirana në Vlorë. Përgjatë këtyre ditëve u organizuan një sërë aktivitete si shfaqje filmash, koncert harqesh, aktivitete letrare dhe muzikore. Por, “qershia mbi tortë” pa diskutim ishin karnavalet Braziliene, një traditë e njohur në mbarë botën.

Energjia dhe kultura unike e Brazilit nisi me një natë poetike më 21 qershor, në Teatrin Metropol, në Tiranë. Interpretimi i poezive dhe prozave të autorëve të mëdhenj, Hilda Hilst, Fernando Pessoa, Miguel Torga dhe novela “The Psychiatrist” nga Machado de Assis, në shqip dhe portugalisht, shoqëruar nga piano, pa diskutim që do të jetë një përvojë e rrallë dhe speciale për të gjithë lexuesit.

Pa dyshim, magjia e Javës Kulturore Braziliene ishin karnavalet që u organizuan në qytetin bregdetar të Vlorës më 29 qershor. Në një shfaqje të paparë më herët në vendin tonë, ky manifestim kulturor solli ritmin, ngrohtësinë dhe ngjyrat e Brazilit në zemrën e bregdetit. Performanca e mrekullueshme e mbi 25 artistëve të ardhur nga Brazili si perkusionistë, balerina dhe kërcimtarë profesionistë, mbajti të mbërthyer për disa orë në Lungomare jo vetëm qytetarët vlonjatë, por edhe turistët e shumtë në qytet. Në këtë shfaqje nuk kishte si të mungonte edhe disiplina e kërcimit luftarak Capoeira, teksa shoqëroheshin dhe nga vespa shumëngjyrëshe, akrobatë të cirkut shqiptar dhe balerinat e Qendrës Kulturore Vlorë.

